



Raporti i - III - | Për Muajin PRILL 2010

# Monitoruesi i Korrupsionit

Raporti i Monitorimit mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit

Publikimi i këtij raporti është mundësuar nga USAID-i, në kuadër të Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë, në partneritet me Institute for Sustainable Communities. Qëndrimet në këtë raport nuk përfaqësojnë qëndrimet e USAID ose ISC.



## Përmbajtja

|                                                                   |    |
|-------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje.....                                                  | 3  |
| Këshilli Gjyqësor i Kosovës.....                                  | 5  |
| Prokuroria e Shtetit.....                                         | 6  |
| Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD).....                           | 8  |
| Njësia e Auditorit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (NJAGJ) ..... | 8  |
| Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit.....                       | 9  |
| Doganat e Kosovës .....                                           | 9  |
| Policia e Kosovës .....                                           | 10 |
| Falënderime .....                                                 | 10 |
| Rreth Lëvizjes “FOL” .....                                        | 10 |

# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit

## Përmbledhje

1. Gjatë muajit Prill nuk është vërejtur ndonjë lëvizje pozitive në luftë kundër korrupsionit, qoftë nga ana e Qeverisë së Kosovës, qoftë nga Kuvendi Kosovar. Përkundër zotimeve të deputetëve dhe zyrtarëve të lartë për përmirësimin e gjendjes, është evidentuar përkushtim i vogël për luftimin e aferave korruptive në institucionet publike. Po ashtu, në fund të muajit që lamë pas, prill, ngjau bastisja në Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të Kosovës (MTPT), si dhe në provat private të Ministrit Limaj dhe shefit të Prokurimit, Nexhat Krasniqi, nga ana e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë – EULEX;
2. Zyrtarët e Policisë së Kosovës (PK) as gjatë prillit nuk kanë shprehur gatishmërinë e tyre që të krijojnë bashkëpunim të ngushtë me ne, në kontekstin e identifikimit dhe informimit me përpjekjet që bëhen nga mekanizmat përgjegjës në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë Lëvizja FOL, prej janarit 2010 ka adresuar disa kërkesa zyrtare për qasje dhe bashkëpunim në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun në Policinë e Kosovës, ende, për fat të keq, nuk ka marrë ndonjë përgjigje – qoftë pozitive – qoftë negative;
3. EULEX-i ka filluar të ndërmarrë hapa konkretë dhe të dukshëm ndaj luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, madje në nivelet më të larta politike. Paralajmërimet e shumta gjatë marsit për hetime edhe në nivelin e lartë politik, për të cilat edhe lëvizja FOL ka përmendur në raportin e muajit Mars, përfundimisht janë bërë publike në muajin Prill. Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit- EULEX ndërmori një aksion bastisës ndaj Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT) dhe të pronave private të Ministrit Fatmir Limaj dhe shefit të Prokurimit Nexhat Krasniqi. Këta të fundit dyshohen për shpëlarje parash, krim të organizuar, shpërdorim të detyrës zyrtare, mashtrim në zyrë dhe ryshfet. Mirëpo, këta janë vetëm dy nga gjithsej gjashtë zyrtarë të profilit të lartë për të cilët flitet të jenë iniciuar hetime publike. Këto bastisje kanë ndodhur menjëherë mbas deklaratave të shumta të përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare dhe thirrjeve të tyre për luftimin e korrupsionit brenda rrethit Qeveritar;
4. Gjatë muajit Prill, në media, është përfolur dhe raportuar që përfaqësues ndërkombëtarë kanë kërkuar nga kryeministri Thaçi ta largojë një ministër të kabinetit të tij, ngase ka dëshmi të shumta për keqpërdorim të fondeve publike. Po në të njëjtin muaj, Ekzekutivi i vendit, ka vendosur të bëjë ndryshime në kabinetin Qeveritar, duke shkarkuar gjashtë ministra, por duke mos shpjeguar arsyen e vërtetë të shkarkimit të tyre;
5. Në gjykatat e Kosovës janë raportuar 143 Lëndë të pazgjidhura, që kanë të bëjnë me shpërdorim të pozitës zyrtare si dhe marrje e dhënie të ryshfetit. Gjatë marsit janë pranuar katër (4) raste të reja, janë zgjidhur tetë (8) raste, ndërsa në fund të këtij muaji, kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 143 raste korruptive;
6. Gjatë muajit Prill, ajo që mund të veçohet është mungesa e prokurorëve të vendit në luftimin e rasteve korruptive të profilit të lartë politik. Në rastin e bastisjeve për dyshim të keqpërdorimeve të buxhetit dhe korrupsionit në Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit, përkatësisht bastisjeve që i janë bërë edhe pronave private të ministrit Fatmir Limaj dhe drejtorit të prokurimit të kësaj ministrie, Nexhat Krasniqi, prokurorët kosovarë nuk e kanë pasur idenë se çfarë kishte ndodhur, e lëre më të përfshihen në

# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit

---

këto aksione;

7. Iniciativa e kryeprokurorit, Ismet Kabashi, që të ketë mbledhje të kolegjiut të prokurorëve për çdo fillim muaji, në të cilën do të raportohet për veprimet dhe rezultatet konkrete të prokurorëve në luftën kundër korrupsionit, ka dështuar në muajin Prill.
8. Lëvizja FOL, gjatë muajit mars, ka raportuar për shifrat e lëndëve që janë publikuar për herë të parë nga Prokuroria e Shtetit, që kanë të bëjnë me lëndët korruptive. Këto lëndë janë dorëzuar nga Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit në Prokuroritë Publike. Ky Agjencion kishte dërguar nëpër prokuroritë e Kosovës, prej vitit 2007, rreth 150 lëndë korruptive, ku dyshohet të jenë përfshirë zyrtarë të ndryshëm që ushtrojnë funksione publike. Që nga ajo kohë, raportet e AKK-së dhe Prokurorisë së Shtetit asnjëherë nuk kanë qenë të mira, pasi zyrtarët e të dyja institucioneve kishin shkëmbyer akuza të ndërsjella për mospunë dhe jo profesionalizëm.

# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit

## Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i cili vepron në kuadër të sistemit gjyqësor, nuk ka shënuar ndonjë aktivitet të veçantë gjatë muajit prill në luftë kundër korrupsionit. Ky institucion, i cili tashmë funksionon me një përbërje të re të anëtarëve të Këshillit, nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim apo vendim specifik në muajt e fundit në drejtim të luftimit të korrupsionit në vend. KGJK-ja, e cila menaxhon gjykatat, punon në kushte të pavoritshme të punës, gjë që pamundësojnë grumbullimin e informatave në kohë dhe në mënyrë elektronike. Edhe në muajin prill, sikundër edhe në muajin e kaluar, Lëvizja FOL ka insistuar të ketë informacion për secilin gjykim që është mbajtur në gjykatat e Kosovës, që ka të bëjë me veprat penale që ndërlidhen me korrupsionin, mirëpo një gjë e tillë ka qenë e pamundur të realizohet.

Por, e tëra që mund të ofrohet në këto kushte nga zyrtarët e Zyrës së Statistikave në këtë institucion, janë të dhënat rreth punës së gjykatësve në gjykimin e vetëm tri llojeve të veprave penale korruptive: marrje të ryshfetit, dhënie të ryshfetit, si dhe shpërdorim të detyrës zyrtare. Këto të dhëna janë siguruar vetëm për muajin mars 2010. Sipas këtyre të dhënave, rezulton se gjatë marsit janë pranuar katër (4) raste të reja, janë zgjidhura tetë (8) raste, ndërsa në fund të këtij muaji, kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 143 raste korruptive. Pra, meqenëse nuk ekziston një formë e duhur e sigurimit të të dhënave, për gjykimin e këtyre rasteve, rrjedhimisht është e pamundur të bëhet një prezantim real i punës apo mos punës së gjykatësve. Arsyeja për një fakt të tillë, mbetet se të dhënat nga gjykatat e Kosovës, sigurohen ende në mënyrë manuale, dhe përmbledhja e tyre nuk bëhet në çdo muaj.

Lëndët Penale të trashëguara, të pranura dhe të zgjidhura sipas kapitullit nga Gjykatat Komunale në Republikën e Kosovës:

| Neni                 | Përshkrimi i llojit të veprave                  | Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese | Lëndë të pranura në punë | Gjithsej lëndë në punë | Gjithsej lëndë të zgjidhura | Lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese |
|----------------------|-------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|--------------------------|------------------------|-----------------------------|------------------------------------------------------|
| 339                  | Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit | 116                                                    | 0                        | 116                    | 6                           | 110                                                  |
| 343                  | Marrja e ryshfetit                              | 18                                                     | 4                        | 22                     | 0                           | 22                                                   |
| 344                  | Dhënia e ryshfetit                              | 13                                                     | 0                        | 13                     | 2                           | 11                                                   |
| Totali sipas linjave |                                                 | 147                                                    | 4                        | 151                    | 8                           | 143                                                  |

## Prokuroria e Shtetit

Ajo që mund të veçohet gjatë muajit prill, në kuadër të Prokurorisë së Shtetit, është mungesa e prokurorëve të vendit në luftimin e rasteve korruptive të profilin të lartë politik. Prokurorët kosovarë, në rastin e bastisjeve në Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe pronave private të ministrit Limaj, si dhe shefit të Prokurimit të kësaj ministrie, Nexhat Krasniqi, për dyshim të keqpërdorimit të buxhetit dhe korrupsionit, nuk ishin fare të informuar se çfarë kishte ndodhur, e mos të flasim për mundësinë e përfshirjes së tyre në këto aksione. Prandaj, përpjekjet për luftimin e korrupsionit, gjatë muajit prill, rezultojnë se janë bërë ekskluzivisht nga Prokuroria e EULEX-it, e cila nuk ka bashkëpunuar fare me Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës. Përndryshe, prokurorët kosovarë nuk kanë shënuar ndonjë aktivitet të veçantë gjatë këtij muaji.

Njashtu, paralajmërimet për zgjidhjen e problemeve ndër-institucionale: Prokurori e Shtetit - Agjenci Kosovare kundër Korrupsionit, nuk kanë rezultuar ende me nënshkrimin e një memorandumi të bashkëpunimit. Sipas kryeprokurorit të Shtetit, Ismet Kabashi, gjatë prillit është përfunduar memorandumi në tërësi dhe, gjatë muajit maj, pritet të bëhet nënshkrimi ndërmjet udhëheqësve të të dyja institucioneve. Ngjashmërisht, Iniciativa e kryeprokurorit Kabashi, që ishte lansuar gjatë marsit për mbledhjen e kolegjiut të prokurorëve në çdo fillim muaji për të raportuar për veprimet dhe rezultatet konkrete të prokurorëve në luftën kundër korrupsionit, në fakt, ka dështuar në prill. Arsye për këtë është situata e krijuar në gjyqësorin e Kosovës, ku gjykatësit dhe prokurorët momental ende nuk dinë se çfarë do të bëhet me fatin e tyre, nëse do të ri emërohen, apo do të përjashtohen nga gjyqësori?! Dhe, në këtë situatë, papërgjegjësia e punonjësve të gjyqësorit, përkatësisht prokurorëve në punën e tyre, është në një nivel shumë të lartë<sup>1</sup>.

Një segment tjetër i rëndësishëm, në të cilin është vazhduar me aktivitete konkrete në krijimin e kushteve për një luftim sa më të efektshëm të korrupsionit, është investimi në Prokurorinë Speciale të Kosovës, gjegjësisht në sektorin anti-korrupsion. Në këtë dikaster, tashmë po punohet në rekrutimin e stafit të policëve hetues të specializuar, ku disa sosh janë pranuar në numër të vogël, ndërsa është shpallur edhe konkursi për pranimin e 25 policëve hetues, të cilët do të merren ekskluzivisht me rastet korruptive. Pra, ky investim, do të rezultojë me krijimin e një prokurorie efikase që trajton vetëm rastet korruptive, praktikë, kjo, që aplikohet edhe në vendet tjera me prezencë të lartë të korrupsionit.

Në muajin mars, Lëvizja FOL, ka raportuar për shifrat e lëndëve që janë publikuar për herë të parë nga Prokuroria e Shtetit, që kanë të bëjnë me lëndët korruptive, e të cilat, në fakt, i kanë pranuar nga Agjencioni Kosovare kundër Korrupsionit. Ky Agjencioni, prej vitit 2007, kishte dërguar nëpër prokuroritë e Kosovës rreth 150 lëndë korruptive, ku dyshohet të jenë përfshirë zyrtarë të ndryshëm që ushtrojnë funksione publike. Që nga ajo kohë, raportet e AKK-së dhe Prokurorisë së Shtetit asnjëherë nuk kishin qenë të mira, pasi zyrtarët e të dyja institucioneve kishin shkëmbyer akuza të ndërsjella për mospunë dhe jo profesionalizëm.

<sup>1</sup> Kryeprokurori i Shtetit, Ismet Kabashi, në një bisedë për Lëvizjen Fol, ka bërë të ditur se situata aktuale, përgjithësisht në gjyqësorin e Kosovës, ka bërë që përgjegjësia e gjykatësve dhe prokurorëve të mos jetë në nivelin e duhur. Kjo ngjarje, sipas tij, për shkak të fazës së riemërimit, e cila zvarritet dhe rrjedhimisht ka shkaktuar huti të gjykatësve dhe prokurorëve aktual, të cilët nuk dinë për fatin e tyre, nëse do të rizgjidhen apo i kanë ditët e fundit si punonjës të gjyqësorit. Kryeprokurori Kabashi, ka thënë se deri në rizgjidhjen e kryeprokurorëve të nivelit të Qarkut, nuk do të mbaj kolegjiutet e paralajmëruara në baza mujore, ngase nuk po sjellin efekt për shkak të kësaj gjendjeje të krijuar.

# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit

AKK-ja, në një numër të madh të lëndëve, nuk kishte marrë përgjigje nga Prokuroria e Shtetit. FOL ka raportuar, që në mars, se prokuroritë nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim në disa lëndë korruptive të profilit të lartë politik. Sipas informacioneve zyrtare të Prokurorisë së Shtetit, në këto lëndë, as në prill, nuk është punuar gjë. Janë gjithsej nëntë lëndë të profilit të lartë politik, në të cilat Prokuroria e Qarkut në Prishtinë ka “fjetur” mbi to. Por, arsyeja për këtë “gjumë”, sipas kryeprokurorit të Qarkut të Prishtinës, Osman Kryeziu, janë mungesa e stafit të prokurorëve dhe kushtet jo të volitshme të punës në këtë prokurori. Mandej, gjithmonë sipas tij, kjo gjendje nuk pritet të përmirësohet përderisa nuk do të ketë strukturë të re të prokurorëve të rizgjedhur në këtë prokurori, të cilët do të jenë në numër shumë më të madh dhe do të shtohen kapacitetet për t’u përballur me numrin e madh të lëndëve që duhet zgjidhur, përfshirë këtu edhe lëndët korruptive<sup>2</sup>. Por, jo vetëm në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, por edhe në Prokuroritë e tjera, për të cilat ka raportuar FOL muajin paraprak, sipas kryeprokurorit të Shtetit, Ismet Kabashi, nuk është vepruar për shkak të mungesës së prokurorëve të pamjaftueshëm

## Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD)

Në mandatin e ZPD-së, siç është e njohur tashmë, përfshihet hetimi i parashtresave kundër gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe prokurorëve, ku, ato, paraqiten me rekomandime për shqiptimin e masave disiplinore nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). ZPD-ja, bazuar në kompetencat ligjore të saj, merret me hetimin e sjelljeve të pahijshme që janë të definuara si shkelje etike dhe deri të kryerja e veprave penale, përfshirë këtu edhe ato korruptive. Gjatë prillit, ky institucion, në punë ka pranuar gjithsej 30 ankesa disiplinore, për të cilat ZPD-ja ka dorëzuar dosjet e përgatitura me shkelje të gjykatësve dhe prokurorëve.

Ky institucion, po ashtu, nuk ka pranuar asnjë vendim me shkrim nga Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e ndonjë rasti gjatë këtij muaji. Pra, KGJK-ja, nuk ka qenë efikase në zgjidhjen e rasteve të keqpërdorimeve që kanë ofruar punonjësit e ZPD-së. Këta të fundit, prej rasteve që kanë pasur në punë, katër të tilla i kanë mbyllur, pasi nuk kanë arritur të gjejnë elemente të keqpërdorimit nga ana e punonjësve të gjyqësorit. Në proces hetimor, ky institucion ka 17 raste, në të cilat po mblidhen prova për të vërtetuar shkeljet e mundshme të gjykatësve dhe prokurorëve. Ndërsa, në 13 raste tjera, ZPD-ja ka refuzuar hetimet, për shkak të parashtresave të ofruara pa argumente të mjaftueshme. Zyrtarët e këtij institucioni, vazhdimisht kanë reaguar ndaj neglizhencës së KGJK-së në shqyrtimin e rasteve që ata adresojnë për t’u zgjidhur në Komisionin Disiplinor<sup>3</sup>.

<sup>2</sup> Në një bisedë që ka zhvilluar FOL me kryeprokurorin e Qarkut të Prishtinës, Osman Kryeziu, ai ka thënë se kjo prokurori ka disa muaj që është në kolaps përse i përket mungesës së stafit të prokurorëve. “Janë vetëm tre prokurorë me të cilët më duhet të mbuloj gjysmën e Kosovës. Ne jemi në kolaps, ngase me këtë numër të prokurorëve është e pamundur të mbulohet puna për të gjitha rastet. Në këto kushte ne jemi duke punuar vetëm në lëndët e natyrës urgjente, në lëndët e paraburgimit”. Sipas Kryeziut, në lëndët e pranuar nga Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit, në nëntë sosh, në të cilat nuk është ndërmarrë asnjë veprim, nuk kanë fjetur prokurorët mbi dosjet korruptive, por mospuna në këto lëndë është si rezultat i mungesës së prokurorëve.

<sup>3</sup> Në një bisedë për FOL, koordinatori i ZPD-së, Kadri Begolli, ka thënë se Komisioni Disiplinor i KGJK-së, për një periudhë të gjatë kohore, ka qenë jofunksional, sikurse edhe vet KGJK-ja. Për shkak të këtij jo-funksionaliteti, dhjetëra lëndë të ZPD-së kanë mbetur të paprekura nga komisioni përkatës. Madje, për një seri të këtyre lëndëve, së fundmi KGJK kishte vendosur që të parashkruante ato (të hidhte në shportë si lëndë të vjetërsuara). Kjo ishte kundërshtuar fuqishëm nga ZPD, puna e së cilës, rrjedhimisht, do të hidhej në shportë. Kadri Begolli kishte paralajmëruar edhe padi ndaj KGJK-së, në rast se ndodh parashkrimi i lëndëve të këtij institucioni.

# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit




Tabela 2: (ZPD) Numri i ankesave të marra nga burime të ndryshme janar- prill 2010

## Njësia e Auditorit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (NJAGJ)

NJAGJ, e cila analizon dhe vlerëson funksionimin e aktiviteteve të përgjithshme dhe specifike të gjykatave dhe të prokurorive, gjatë prillit ka vazhduar me auditivin rutinor. Edhe gjatë këtij muaji është vazhduar me identifikimin e problemeve të përditshme në punën e gjykatësve dhe prokurorëve. Ky mekanizëm, në fakt, ka nxjerrë në shesh ngecjet kryesore të mos-funksionimit të gjyqësorit, të cilat informacione do të bëhen publike gjatë muajve në vazhdim. Në këtë kuadër, NJAGJ ka shtjelluar probleme konkrete të moszbatimit të akteve ligjore, që në njëfarë mënyre, ndërlidhen me veprimtari të kundërligjshme dhe korruptive.

## **Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit**

Zyrtarët e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, gjatë prillit, kanë kryer aktivitetet e zakonshme, duke qenë një derë e hapur për deklarimin e veprimtarive korruptive nga qytetarët. Pra, nuk është shënuar me ndonjë aktivitet të veçantë. Madje, njëjtë sikurse që është theksuar në pjesën e Prokurorisë së Shtetit, me këtë institucion të rëndësishëm dhe të domosdoshëm ende nuk e kanë finalizuar me nënshkrim memorandumit e bashkëpunimit ndër-institucional. Ky memorandum, pritët të nënshkruhet gjatë majit. Mentor Borovci, drejtor i Hetimeve në AKK, ka thënë se përmes këtij memorandumit, pritët të forcohet dhe konkretizohet më tutje bashkëpunimi midis këtyre dy mekanizmave shtetëror për luftimin e korrupsionit.

Gjatë prillit, AKK-ja, ka punuar në selektimin dhe skanimin e të gjithë formularëve, proces, ky, i cili pritët të përfundojë para 1 qershorit. Pas kësaj date, pritët të bëhen publike të dhënat në ueb-sajtin e AKK-së. Sipas Borovcit, me këtë rast do të dalin të gjithë emrat e atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë, si dhe ndaj tyre do të fillojnë procedurat për sanksionim, konform dispozitave të parapara me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë. Zyrtarët e këtij Agjencioni, kanë njoftuar, po ashtu, se edhe pas afatit të paraparë zyrtarët kanë vazhduar të deklarojnë pasurinë, ndaj edhe të gjithë formularët e tillë, sipas tyre, janë duke u skanuar. Përfaqësuesit e AKK-së nuk kanë dashur, që zyrtarisht, të komentojnë zhvillimet dhe kontributin që ky institucion ka mundur të jap në rastin e hetimeve për keqpërdorime dhe korrupsion në MTPT!

## **Doganat e Kosovës**

Bazuar në të dhënat zyrtare të anti-korrupsionit të Doganave të Kosovës, për prillin e këtij viti, rezulton se ky institucion ka shqiptuar gjithsej 18 masa disiplinore ndaj punonjësve të saj, të cilët janë “roja” në vendet e punës, ku edhe veprimtaritë e kundërligjshme dhe korruptive janë shumë të shpeshta. Ndaj punonjësve të saj, për shkak të shkeljeve të rregullave të punës, Doganat e Kosovës, gjatë prillit, kanë shqiptuar 4 vërejtje me shkrim, 4 vërejtje me gojë, 2 degradime, 4 ndalime për promovim për periudhë të caktuar kohore, anulim të performancës, si dhe 2 trajnime të detyrueshme. Sipas zyrtarëve të Doganave të Kosovës, këto masa janë të shqiptuara për sjellje jo profesionale, neglizhencë në punë dhe mos deklarim të pasurisë.

## Policia e Kosovës

Zyrtarët e Policisë së Kosovës (PK) nuk kanë shprehur, as gjatë prillit, gatishmërinë e tyre që të krijojnë bashkëpunim në dobi të identifikimit dhe informimit me përpjekjet që bëhen nga mekanizmat përgjegjës në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë Lëvizja FOL, prej janarit 2010, ka adresuar disa kërkesa zyrtare për qasje dhe bashkëpunim në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun në Policinë e Kosovës, ende nuk ka marrë asnjë përgjigje – qoftë pozitive - qoftë negative. Lëvizja FOL, përmes këtij projekti, mëton të nxjerrë në shesh punën dhe mospunën e institucioneve që obligohen të luftojnë korrupsionin, në mënyrë që këto çështje të ngritën në nivelin e duhur të përgjegjësisë dhe me qëllim të vetëm që të ketë efikasitet në luftën anti-korrupsion. FOL, me gjithë pamjen e zymtë, mbetet me shpresë që edhe Policia e Kosovës do të ofrojë bashkëpunimin e saj, për të identifikuar luftën e vërtetë të cilën ajo e bën përditë kundër dukurisë së korrupsionit.

## Falënderime

Publikimi i këtij Raporti është mundësuar nga USAID-i, në kuadër të Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë, si dhe në partneritet me Institute for Sustainable Communities. Qëndrimet në këtë Raport, megjithatë, nuk përfaqësojnë qëndrimet e USAID-it ose ISC-së.

Ky Raport është rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti.

Të gjitha raportet mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë website: [www.monikorr.org](http://www.monikorr.org)

## Rreth Lëvizjes “FOL”

FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje.

Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasje në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.